

Worcester Public Schools

Plan Parandalimi dhe Ndërhyrje për Ngacmimin (Bullying)

www.worcesterschools.org/bullying-prevention

TABELA E PERBBAJTJES

| | | |
|-------|--|----------|
| I. | DREJTIMI (LEADERSHIP)..... | Faqja 2 |
| II. | TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL..... | Faqja 3 |
| III. | AKSES PER RESURSET DHE SHERBIMET..... | Faqja 4 |
| IV. | AKTIVITETET AKADEMIKE DHE JO-AKADEMIKE..... | Faqja 6 |
| V. | RREGULLAT DHE PROCEDURAT PER RAPORTIMIN DHE PERGJIGJEN NDAJ NGACMIMIT DHE HAKMARRJES..... | Faqja 7 |
| VI. | BASHKEPUNIMI ME FAMILJET..... | Faqja 13 |
| VII. | NDALIMI KUNDER NGACMIMIT DHE HAKMARRJES..... | Faqja 14 |
| VIII. | PERKUFIZIMET..... | Faqja 14 |
| IX. | LIDHJA ME LIGJET E TJERA..... | Faqja 15 |
| X. | SHTOJCA..... | Faqja 16 |

Shkollat Publike Worcester janë një Mundësi e Barabartë/Punëdhënes me Veprim Afirmativ/Institucion Edukimi që nuk bën dallim pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, moshës, besimit fetar, origjinës kombëtare, gjendjes civile, prirjeve seksuale, identitetit gjinor, paaftesisë apo vendstrehimit. Shkollat Publike Worcester sigurojnë punësim të barabartë dhe një sërë programesh edukimi të përgjithshëm dhe profesional. Për më tepër informacion në lidhje me këtë Mundësi të Barabartë /Veprim Afirmativ, kontaktoni Manaxherin e Burimeve Njerëzore, 20 Irving Street, Worcester, MA 01609, 508-799-3020.

Shkollat Publike të Worcester-it
Plan Parandalues dhe Ndërhyrje Ndaj Ngacmimit (Bullying Prevention and Intervention Plan)

Deklarata e Qëllimit (Statement of Purpose)

Plani Parandalues dhe Ndërhyrës Ndaj Ngacmimit të Shkollave Publike të Worcester-it është një qasje gjithëpërfshirëse për adresimin e Ngacmimit (bullying) dhe, Ngacmimit Kibernetik (cyber-bullying). Komuniteti i Shkollave Publike të Worcester-it to da trajtojë njëti-tjetrin në një mënyrë civile dhe me respekt për të gjitha diferencat. Shkollat Publike të Worcester-it janë të angazhuara për të punuar me nxënësit, stafin, familjet, agjensitë e zbatimit të ligjit, si dhe me komunitetin për të parandaluar problemet e dhunës. Në konsultim me këta partnerë, ne kemi krijuar këtë Plan për parandalimin, ndërhyrjen dhe përgjigjen ndaj incidenteve të ngacmimit, ngacmimit kibernetik dhe hakmarrjes. Distrikti i merr seriozisht përgjegjësitë e tij për implementimin e këtij Plani për tu garantuar nxënësve një mbrojtje nga ngacmimi.

Shkollat Publike të Worcester-it janë të angazhuara për tu ofruar të gjithë nxënësve një mjedis mësimor të sigurtë që është pa ngacmim në person dhe ngacmim kibernetik. Ky angazhim është një pjesë integrale e përpjekjeve tona të përgjithshme për të promovuar mësimin dhe për të parandaluar dhe eliminuar të gjitha format e ngacmimit dhe sjelljet e tjera të dëmshme dhe të çrregullta të cilat mund të pengojnë procesin mësimor dhe rezultatet e mira për të gjithë nxënësit. Ne e pranojmë se disa nxënës mund të jenë më vulnerabël për të qënë objekt ngacmimi bazuar në karakteristika aktuale ose të perceptuara, përfshirë racën, ngjyrën, besimin fetar, prejardhjen, origjinën kombëtare, seksin, statusin socio-ekonomik, strehimin, statusin akademik, identitetin ose pasqyrimin gjinor, pamjen fizike, shtatëzaninë ose statusin prindëror, orientimin seksual, mental, paaftësitë fizike ose sensore, ose nga shoqëria me një person që ka ose perceptohet se ka një ose më shumë nga këto karakteristika.

Shkollat Publike të Worcester-it nuk do të tolerojnë asnjë sjellje të paligjshme dhe të çrregullt, përfshirë çdo formë ngacmimi, ngacmimi kibernetik, ose hakmarrjeje në ndërtesat e Shkollave Publike të Worcester-it, në ambjentet shkollore, ose në aktivitetet e lidhura me shkollën. Ne do të investigojmë me përpikmëri të gjithë raportet dhe ankesat për ngacmim, ngacmim kibernetik dhe hakmarrje, dhe do të veprojmë menjëherë për ti dhënë fund sjelljes ngacmuese si dhe për ti rikthyer sensin e sigurisë viktimës. Ne do të mbështesim këtë angazhim në të gjitha aspektet e komunitetit të shkollës, programit mësimor, programeve udhëzuese, trajnimit e stafit, dhe aktivitetet e tjera jashtë mësimore, dhe do të angazhojmë prindërit/kujdestarët për mbështetjen e tyre në parandalimin e ngacmimeve.

I. DREJTIMI/UDHEHEQJA (LEADERSHIP):

Drejtimi në të gjitha nivelet luan një rol kritik në krijimin dhe implementimin e Worcester Public Schools Bullying Prevention and Intervention Plan. Roli kryesor i drejtuesve është që tu mësojnë nxënësve që të jenë të sjellshëm me njëri-tjetrin dhe të promovojnë kuptimin dhe respektin për diversitetin dhe diferencat. Drejtuesit e Distriktit, përfshirë ,Chief Academic Officer, anëtarët e caktuar të stafit dhe drejtuesit e vendosur në shkollë janë përgjegjës për këtë iniciativë. Ata do të caktojnë prioritetet dhe do të përdorin kërkimet për të rregulluar planin, për të qënë sa më efektiv në përgjigjen ndaj ngacmimeve.

A. Përfshirja e publikut ishte e rëndësishme në krijimin e Planit. Worcester Public Schools Bullying Prevention and Intervention Plan u krijua në konsultime me mësuesit, stafin e shkollës, personelin e mbështetjes profesionale, vullnetarët në shkollë, administratorët, përfaqësuesit e komunitetit, agjensitë lokale të zbatimit të ligjit, nxënësit, prindërit dhe kujdestarët siç kërkohet nga M.G.L. c. 71, § 37O. Shkollat Publike të Worcester-it kanë angazhuar aktivisht këto palë të interesuara në këtë proces. Ne mbajtëm një tryezë të rumbullakët për parandalimin e ngacmimit me diskutime, dhënie dhe marrje opinionesh në Citywide Parent Planning Parent Advisory Council, në Special Education Advisory Council, në School Committee Teaching, Learning dhe në Student Supports Sub-Committee, anketim të nxënësve në Superintendent's Student Advisory Council, dhe zhvilluam seanca informuese në kanalet lokale të televizionit

B. Palët e interesuara të brendshme dhe të jashtme ishin të dobishme në vlerësimin e nevojave dhe burimeve. Ky Plan shërben si projekt i distriktit për rritjen e kapacitetit të parandalimit dhe përgjigjes për problemet e ngacmimit në kontekstin e programeve dhe iniciativave ekzistuese të shkollës. Këto përfshijnë:

1. Ndërhyrje dhe Mbështetje për Sjelljet Pozitive në të gjithë Shkollën.
2. Hapi i Dytë: Një Program Mësimor për Parandalimin e Dhunës; Klasat K-2
3. Hapat që duhen respektuar: Një program Mësimor për Parandalimin e Ngacmimit; Klasat 3-6
4. Diskutime rreth Prekjes: Një Program Mësimor për Sigurinë Personale; Klasat K-3
5. Michigan Model i Plotë për Programin Mësimor Shëndetsor të Shkollës; Klasat K-12
6. Trajnim për Aftësitë e Jetësore; Klasat 4-10
7. Takimet e Sigurta: Një Program Mësimor për Parandalimin e Abuzimeve në Takimet(dates) e Adoleshentëve; Klasat 8-10
8. Program për Parandalimin dhe Ndërrjen e Bandave

Nën drejtimin e Director of Health Education, dhe drejtuesve të shkollës, me të dhëna nga familjet dhe stafi; me vlerësimin vjetor për përshtatshmërinë e këtyre programeve; rishikimin e rregullave dhe procedurave aktuale; shqyrtimin e të dhënave të disponueshme për ngacmimin dhe incidentet e sjelljes; dhe vlerësimin e risurseve të disponueshme përfshirë programin mësimor, programet trajnuese, dhe shërbimet e sjelljes shëndetsore. Ky proces 'hartues' ndihmon shkollat tona dhe distriktin në identifikimin e hapësirave të risorseve dhe fushat më të rëndësishme të nevojës. Rekomandimet do të dërgohen Chief Academic Officer për përdorim të mundshëm në nivel distrikti për të rishikuar dhe krijuar rregulla dhe procedura; krijojë partneritete me agjensitë e komunitetit, përfshirë ato të zbatimit të ligjit; dhe të vendosë prioritetet për Shkollat Publike të Worcester-it.

Distrikti dhe shkolla të veçanta me mbështetje nga School Safety Liaison mbledhin dhe analizojnë të dhënat specifike për atë shkollë, për përhapjen dhe karakteristikat e ngacmimit (p.sh fokusim në identifikimin e popullatës më vulnerabël dhe vendet 'më të nxehta' në shkollë, ose ambientin shkollor, ose në autobuzët e shkollës). Ky informacion ndihmon në identifikimin e modeleve të sjelljes si dhe fushat shqetësuese, dhe informon vendim-marrësit për strategjitë e parandalimit përfshirë, por jo të limituar në, mbikqyrjen nga të rritur, zhvillimin profesional, program mësimor të përshtatshëm për moshën, dhe shërbime ndihmuese në shkollë.

Safe and Secure Learning Environment Committee konsiston në pjesëtarë të stafit të zyrave në shkollë dhe zyrave qëndrore, përfaqësues nga prindërit dhe nxënësit si dhe nga palët e interesuara të komunitetit. Ky komitet do të kryejë një vlerësim vjetor të nevojave për të informuar për rishikime dhe përmirësime të Planit.

C. Planifikimi dhe Mbikqyrja:

The Bullying and Intervention Plan ("Plan") është një qasje gjithëpërfshirëse për adresimin e ngacmimit dhe ngacmimit kibernetik, dhe

distrikti shkollor është i angazhuar për të punuar me nxënësit, stafin, familjet, agjensitë e zbatimit të ligjit, dhe me komunitetin për të parandaluar problemet e dhunës. Në bashkëpunim me këto grupe interesi ne kemi krijuar këtë Plan për parandalimin, ndërhyrjen dhe përgjigjen ndaj incidenteve të ngacmimit, ngacmimit kibernetik dhe hakmarrjes. Drejtori ose i emëruari i tij/saj është përgjegjës për implementimin dhe mbikqyrjen e planit me përjashtim të rastit kur një ngacmim i raportuar përfshin drejtorin ose nën drejtorin si agresorë të pretenduar. Në këto raste, Superintendent ose i emëruari i saj duhet të jenë përgjegjës për investigimin e raportimit, dhe hapat e tjerë të nevojshëm për implementimin e Planit, përfshirë adresimin e sigurisë së objektivit/viktimës të pretenduar. Nëse Superintendent është agresori i pretenduar, Komiteti i Shkollës, ose i emëruari duhet të jenë përgjegjës për investigimin e raportimit dhe hapat e tjerë të nevojshëm për implementimin e Planit, përfshirë adresimin e sigurisë së objektivit të pretenduar.

Tabela e mëposhtme nënvizon detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesit në Plan:

| DETYRAT | DREJTUESIT |
|---|--|
| Marrin raporte për ngacmimin | School Committee or Designee Superintendent or Designee School Principals School Safety Liaison |
| Mbledhin dhe analizojnë të dhënat e shkollës për ngacmimin për të vlerësuar problemin aktual dhe për të matur arritjet e përmirësuar | Chief Accountability Officer School Safety Liaison Safe and Secure Learning Environment Committee |
| Krijojnë një proces për regjistrimin dhe ndjekjen e raportimeve të incidenteve, dhe për të vlerësuar informacionin në lidhje me objektivat dhe agresorët | Information Systems Officer School Safety Liaison Safe and Secure Learning Environment Committee |
| Planifikim për zhvillimin e vazhdueshëm profesional që kërkohet me ligj | Manager of Professional Development School Safety Liaison Safe and Secure Learning Environment Committee |
| Planifikojnë ndihmë që i përgjigjet nevojave të objektiveve dhe agresorëve | Coordinator of Counseling, Psychology, and Community Outreach Services Safe and Secure Learning Environment Committee |
| Zgjedhin dhe implementojnë programin mësimor që shkolla dhe distrikti do të përdorin | Health and Physical Education Liaison Safe and Secure Learning Environment Committee |
| Krijojnë rregulla dhe protokolle të reja ose rishikojnë ato aktuale sipas Planit, përfshirë një rregullore për sigurinë në internet | Chief Academic Officer Safe and Secure Learning Environment Committee |
| Ndryshojnë manualin e nxënësve, stafit dhe kodin e sjelljes ndërmjet të tjerash, dhe bëjnë të qartë se ngacmimi ndaj nxënësve nga stafi dhe nxënësit e tjerë nuk do të tolerohet. | Chief Academic Officer Safe and Secure Learning Environment Committee |
| Kryesojnë përpjekjet e angazhimit të prindërve ose familjeve dhe hartojnë materialet për informimin e prindërve | Communication and School Support Coordinator School Safety Liaison Safe and Secure Learning Environment Committee |
| Rishikojnë dhe rifreskojnë në mënyrë frekvente Planin çdo vit, ose më shumë | Safe and Secure Learning Environment Committee School Safety Liaison |

II. TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Shkollat Publike të Worcester-it ofrojnë zhvillim profesional të vazhdueshëm për të gjithë stafin, përfshirë por jo të limituar në, mësuesit, administratorët, konsullorët, infermierin e shkollës, mirëmbajtësit, shoferët e autobuzëve, punonjësit e menceve, trajnerët e sporteve, këshilltarët, këshilltarët për aktivitetet jashtë shkollore dhe paraprofesionale në përputhje me M.G.L. c. 71, § 37O.

A. Trajnim vjetor i stafit. Shkollat Publike të Worcester-it do të zhvillojnë një trajnim vjetor për të gjithë stafin e shkollave për Planin. Ky trajnim fokusohet në; identifikimin e sjelljeve ngacmuese, llojet e ngacmimit, rolet e agresorëve, objektivat, spektatorët, të drejtat dhe përgjegjësitë sipas M.G.L. c. 71, § 37O, përgjegjësitë e stafit sipas Planit, një pamje e përgjithshme e hapave që drejtori ose i emëruari administrativ do të ndjekë sapo të marrë një raportim për ngacmim ose hakmarrje, si dhe një pamje e përgjithshme e programit mësimor për parandalimin e ngacmimit do të jepet në të gjitha klasat e të gjitha Shkollave

Publike të Worcester-it. Ekipet nga çdo shkollë përfshirë drejtorin, nën-drejtorin, konsullorët dhe edukatorët shëndetësorë janë trajnuar në të gjitha aspektet e Planit. Pastaj çdo ekip trajnon stafin e shkollës së tij përfshirë mësuesit, administratorët, konsullorët, infermieret, punëtorët e mençur, mirëmbajtësit, këshilltarët, dhe këshilltarët për aktivitetet jashtë shkollore dhe paraprofesionale. Shoferët e autobuzave trajnohen nga School Safety Liaison. Trajnerët e sporteve trajnohen nga Director of Athletics.

Anëtarëve të stafit të punësuar pas fillimit të vitit shkollor do tju kërkohet që të marrin pjesë në këtë trajnim për parandalimin dhe ndërhyrjen ndaj ngacmimit si pjesë e orientimit të tyre nga Shkollat Publike të Worcester-it.

B. Zhvillim profesional në vazhdim. Shkollat Publike të Worcester-it do të vazhdojnë që të ndërtojnë aftësitë e anëtarëve të stafit për parandalimin, identifikimin, dhe përgjigjen ndaj ngacmimit nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Përmbajtja e zhvillimit profesional në shkollë dhe distrikt merret nga kërkimet dhe përfshin informacion në:

1. zhvillimin (ose moshën-) strategjike e përshtatshme të moshës për të parandaluar ngacmimin
2. zhvillimin (ose moshën-) strategjike e përshtatshme të moshës për ndërhyrje të menjëhershme dhe efektive për ndalimin e incidenteve të ngacmimit;
3. informacion në lidhje me ndërveprime komplekse dhe diferencat në pushtet që mund të ndodhin ndërmjet një agresori, objektivit, dhe dëshmitarëve të ngacmimit;
4. rezultatet e kërkimeve për ngacmimet, përfshirë informacionin rreth kategorive specifike të nxënësve që kanë treguar se janë veçanërisht në rrezik për ngacmim në ambjentin shkollor;
5. informacion për ndodhjen dhe natyrën e ngacmimit kibernetik; dhe
6. çështjet e sigurisë së internetit sepse janë të lidhura me ngacmimin kibernetik.

Zhvillimi profesional adreson gjithashtu edhe rrugët e mundshme të parandalimit dhe përgjigjes ndaj ngacmimit ose hakmarrjes për nxënësit me paaftësi që duhet të merren në konsideratë kur krijohet Individualized Education Programs (IEPs) për nxënësin me një fokus të veçantë në nevojat e nxënësve me autizëm ose nxënësve tek të cilët paaftësia ndikon në zhvillimin e aftësive sociale.

Fusha të tjera për zhvillim profesional mund të përfshijnë:

- promovimin dhe demonstrimin e përdorimit të gjuhës respektuese;
- nxitja e të kuptuarit dhe respektit për diversitetin dhe diferencat;
- ngritja e marrëdhënieve dhe komunikimi me familjet;
- manaxhimi konstruktiv i sjelljeve në klasë;
- përdorimi i strategjive pozitive për ndërhyrjet në sjellje;
- aplikimi i praktikave disiplinore konstruktive;
- mësimi i aftësive për nxënësit përfshirë komunikimin, manaxhimin e zemërimit, dhe simpati për të tjerët;
- angazhimi i nxënësve në planifikimin në klasë dhe në shkollë si dhe vendim-marrje;
- mbajtja e një klase të sigurtë dhe dashamirëse për të gjithë nxënësit; dhe
- angazhimi i stafit dhe atyre që janë përgjegjës për implementimin dhe mbikqyrjen e Planit për të dalluar ndërmjet sjelljeve të pranueshme manaxheriale të krijuara për të korrigjuar sjelljen e keqe, instalimin e përgjegjësive në ambjentin shkollor, etj dhe sjelljeve ngacmuese.

C. Njoftime me shkrim për stafin. Distrikti i ofron gjithë stafit një njoftim vjetor me shkrim nga Shkollat Publike të Worcester-it për Schools Bullying Prevention and Intervention Plan duke publikuar në buletin e Superintendent informacioni rreth tij, përfshirë seksione që lidhen me detyrat e stafit dhe ngacmimi i nxënësve nga stafi i shkollës. Ai gjithashtu vendoset edhe në adresën e internetit dhe në çdo ndërtesë shkolle.

III. AKSES PER RESURSET DHE SHERBIMET

Një aspekt kyç në promovimin e një ambjenti mësimor të sigurtë në të gjitha Shkollat Publike të Worcester-it është garancia se nevojat themelore emocionale të viktimës, nxënësve, dhe agresorëve adresohen. Në mënyrë që të rriten kapacitetet e distriktit në parandalimin, ndërhyrjen e hershme dhe përgjigjen efektive ndaj ngacmimit, Shkollat Publike të Worcester-it kanë në dispozicion resurse që reflektojnë një kuptueshmëri të dinamikës së ngacmimit dhe ofrojnë qasje për të adresuar nevojat e objektivave, nxënësve dhe familjeve.

A. Identifikimi i Resurseve. Iniciativa e distriktit në Positive Behavior Interventions and Supports (PBIS) aktualisht në 27 shkolla dhe programet alternative ofrojnë një kornizë të fuqishme për vendosjen e një pritshmërie për sjelljen e zakonshme dhe një kulturë respekti nga i gjithë stafi në çdo shkollë. Resurset e disponueshme për mbështetjen e përdorimit të kësaj qasjeje gjerësisht në shkollë përfshijn trajnimin e stafit në aftësitë e mësimit të nxënësve, të sjelljeve të përshtatshme sociale dhe në krijimin e një ambjenti pozitiv në shkollë që ndihmon sjelljet e përshtatshme interpersonale. “Strategjitë e suksesshme” nga shkollat e distriktit që implementojnë PBIS janë të disponueshme në adresën e internetit të distriktit së bashku me lidhje për resurse të tjera si dhe National Center on Positive Behavior Supports (<http://www.pbis.org>). Mësimi i saktë i sjelljeve të përshtatshme sociale në çdo nivel nga të gjithë të rriturit në mjedisin shkollor është në përputhje me iniciativat e distrikteve të tjerë duke përfshirë edhe pjesëmarrjen tonë në Central Massachusetts Child Trauma Center. Brënda shkollave PBIS funksionon një strukturë e krijuar për zgjidhjen e problemeve që vepron në identifikimin aktiv dhe adresimin e problemeve të sjelljes sapo ato ndodhin dhe krijon strategji për parandalimin sipas nevojës. Gjithashtu të formalizuara brënda shkollave PBIS janë edhe burimet e suportit për lidhjet me familjen të bazuara në komunitet.

B. Këshillimi dhe shërbimet e tjera. School Adjustment Counselors dhe School Psychologists janë caktuar në çdo shkollë si me kapacitet të plotë ashtu edhe me kohë të pjesëshme nga Child Study Department (Shiko Shtojcën për përshkrimin e for Child Study Department). Gjatë detyrave të tyre në shkollë këta profesionistë të shëndetit mendor kanë njohje me anëtarët e besuar të çdo komiteti shkollor që janë të disponueshëm menjëherë për të asistuar vlerësimet e situatave që kanë lidhje me ngacmimet, ose frikën ndërmjet nxënësve. Sipas rastit ata ndihmojnë me krijimin dhe implementimin e Student Support Plans për nxënësit që kanë qënë objekt ngacmimi dhe gjithashtu referojnë prindërit dhe nxënësit tek burimet e mbështetjes të bazuara në komunitet. Veç kësaj, këta anëtarë të stafit ndihmues përforcojnë aftësitë sociale të programit mësimor duke para-mësuar ose ri-mësuar aftësitë që adresohen nga mësuesit e Edukimit Shëndetsor për individë ose grupe të vogla nxënësish të cilëve u nevojitet ekspozim i vazhdueshëm ndaj këtyre leksioneve. Këshilltarët e përshtatjes në shkollë ofrojnë shërbime këshillimi afat-shkurtër për individë ose grupe nxënësish, shërbejnë si manaxherë çeshtjeje për nxënësit/familjet në krijimin e një rrjeti shërbimesh ndihmëse me agjensitë e komunitetit, ofrojnë një zgjidhje jo të dhunshme për konfliktet dhe shërbime ndërmjetësi.

Këshilltarët e Përshtatjes në Shkollë (School Adjustment Counselors) shërbejnë gjithashtu edhe si Supervisors of Attendance të distriktit, dhe si të tillë mund të identifikojnë ngacmimin që përshkallëzohet në nivel të lartë mungesash për shkak të shmangies së shkollës. Nëpërmjet punës bashkëpunuese me Worcester Juvenile Court’s Clerk Magistrate dhe Probation Departments aplikimet për ndihmë formale dhe informale nëpërmjet këtyre zyrave shpesh përshpejton vëmendjen e duhur për këto çështje dhe probleme.

Student School Safety Center me personel nga School Adjustment Counselors dhe nga një mësues i licencuar për edukimin special, ofrojnë një opsion afat-shkurtër (3 ditë) nëpërmjet të cilit nxënësit që janë angazhuar në ngacmime serioze dhe sjellje kërcënuese të marrin vlerësim intensiv për nevojat dhe, një pjesë e programit mësimor të bazuar në kërkime që krijojnë aftësi zgjidhjeje të konfliktit pozitive dhe jo të dhunshme. Kjo ndërhyrje e duhur edukative shërben për të mësuar sjellje zëvendësuese të pranueshme, të identifikojë nevojat e nxënësit dhe krijojë një plan ndihmues për implementimin kur nxënësit të kthehen në shkollat e tyre. Safety Center u dërgon gjithashtu nxënësve një mesazh të qartë në lidhje me sjelljen e pranueshme dhe të pritëshme.

Temporary Learning Center (TLC), ofron vlerësim afat-shkurtër dhe stabilizim për nxënësit e fillores të cilët shfaqin një histori serioze me probleme të sjelljes/emocionale që pengojnë progresin e tyre akademik si dhe atë të shokëve dhe shoqeve të tyre në klasë. Nxënësit dalin nga programi pas 2-3 javësh me një plan për të ndihmuar mësimet e tyre, sjelljen, dhe suksesin emocional dhe social në klasën kryesore. Në klasën TLC një mjedis i vogël, dhe shumë i strukturuar u lejon mësim intensiv të sjelljeve të përshtatshme. Plane të tjera ndihmues përshtaten sipas nevojave individuale të çdo nxënësi dhe, sipas rastit, sipas nevojës së familjes së tyre.

C. Nxënësit me Paaftësi. Për nxënësit e Shkollave Publike të Worcester-it me spektër autizmi ekipi i IEP duhet të konsiderojë dhe adresojë në mënyrë specifike aftësitë dhe zotësitë e nevojshme për të shmangur, ose përgjigjur ngacmimit. Sa herë që ekipi i IEP vlerësues tregon që paaftësia e bën nxënësin vulnerabël për ngacmim, IEP duhet që të adresojë aftësitë dhe zotësitë e nevojshme për të shmangur dhe përgjigjur ngacmimit.

D. Referencë tek Shërbimet e Jashtme. School-Based Intake Process (Shiko Udhëzimet në Shtojcë) ofron një protokoll për praktikë ndërmjet distriktit shkollor dhe agjensive që ofrojnë kujdes shëndetsor mental, i cili shpejton referimin dhe

përputhjen e klinikistit të duhur me nxënësin që i nevojitet trajtimi i lidhur me funksionimin e tij/saj socio/emocional. Njëpërmjet përdorimit të këtij procesi School Adjustment Counselors dhe Psikologu i shkollës janë në gjendje që të asistojnë familjet të cilat ndryshe do të kishin probleme në gjetjen e klinikistit të duhur për trajtimin e shëndetit mendor. Për më shumë, leja e firmosur nga prindi që konsiston në një School-Based Intake i lejon stafit të shkollës që të ndajë informacionin në lidhje me çështjet shqetësues që kërkojnë referencë të shpejtë. Gjatë këtij procesi shqetësimet që lidhen me sjelljen ngacmuese që identifikohen nga shkolla mund të komunikohen ofruesit të bazuar në komunitet duke bërë të mundur që problemi të adresohet me planin e përgjithshëm trajtues.

IV. AKTIVITETET AKADEMIKE DHE JO-AKADEMIKE

Shkollat Publike të Worcester-it ofrojnë udhëzime të përshtatshme me moshën në parandalimin e ngacmimeve në çdo klasë, të cilat distrikti i përfshin në programin mësimor të shëndetit bazuar në evidencë. Udhëzimet efektive përfshijnë qasjet në klasë dhe iniciativat të të gjithë shkollës të cilat fokusohen në strategjitë për parandalimin e ngacmimeve dhe krijimin e aftësive sociale.

Prioritetet e vendosura nga Shollat Publike të Worcester-it:

A. Qasje specifike për parandalimin e ngacmimit. Programi për parandalimin e ngacmimit vazhdon që të pasurohet nga informacioni që vjen nga kërkimet të cilat, ndër të tjera, vënë theksin në metodat e mëposhtme:

- përdorimi i shkrimeve dhe i akteve (role play) në zhvillimin e aftësisë;
- autorizimi i nxënësve ose stafit të shkollës që të marrin masa, duke ditur se çfarë të bëjnë kur ata janë dëshmitarë kur nxënësit e tjerë angazhohen në ngacmime ose hakmarrje, përfshirë kërkimin e ndihmës nga të rriturit;
- ndihmimi i nxënësve për të kuptuar dinamikën e ngacmimit dhe ngacmimit kibernetik, përfshirë mosbalancimi i pushtetit;
- vënia e theksit në sigurinë kibernetike, përfshirë përdorimin e sigurtë dhe siç duhet të teknologjisë elektronike komunikuese;
- rritja e aftësive të nxënësit për angazhimin në marrëdhënie të shëndetshme dhe komunikim të respektueshëm; dhe
- angazhimi i nxënësve në një ambient shkollor të sigurtë dhe ndihmues, dhe që respekton diversitetin dhe diferencat.

Iniciativat përfshijnë gjithashtu edhe mësimin e nxënësve rreth seksioneve që lidhen me nxënësit të Bullying Prevention and Intervention Plan në fillim të çdo viti shkollor nëpërmjet mbledhjeve të nxënësve, mësimave në klasë dhe mesazheve në të gjithë shkollën.

Programi i parandalimit të ngacmimit i bazuar në evidencë është përshkruar mëposhtë:

SHKOLLAT FILLORE (ELEMENTARY SCHOOLS)

Shkollat Publike të Worcester-it kanë mësues për shëndetin në të gjithë sistemin të cilët mësojnë të gjithë nxënësit në klasat 1-6 në të gjitha shkollat fillore. Ata përdorin programin e mëposhtëm të bazuar në evidencë për aftësitë sociale dhe parandalimin e ngacmimit dhe dhunës:

- Klasat 4-6 Hapat e Respektit (Steps to Respect), Michigan Model for Comprehensive School Health Education

Mësuesit e klasës qëndrojnë në klasë kur mësohen këto klasa për të bashkë-lehtësuar dhe përforcuar leksionin gjatë javës.

SHKOLLAT TETEVJECARE (MIDDLE SCHOOLS)

Cdo shkollë tetëvjeçare ka një mësues me kohë të plotë për shëndetin i cili/cila mëson dhunën dhe parandalimin e ngacmimit duke përdorur Agresorë (Aggressors), Victima, dhe Spektatorë (Bystanders) si dhe parandalim i Violences dhe Dëmtimit, korikulum HealthSmart dhe Michigan Model resources.

SHKOLLAT E MESME (HIGH SCHOOLS)

Mësuesit për shëndetin japin leksione duke përdorur Teenage Health Teaching Module: Violence Prevention and the Michigan Model për Comprehensive School Health Education dhe parandalim i Violences dhe Dëmtimit, korikulum HealthSmart dhe Michigan Model resources.

Zyra e Prokurorit të Distriktit gjithashtu ofron takime pune për nxënësit në lidhje me ngacmimin në nivele të tjera klase. Ata do të ndihmojnë nxënësin në kuptimin e dinamikës së ngacmimit dhe ngacmimit kibernetik duke vënë theksin tek siguria kibernetike, përfshirë përdorimin e sigurtë dhe siç duhet të teknologjisë elektronike të komunikimit.

Shkollat Publike të Worcester-it njohin rëndësinë e këtij ligji dhe ofrojnë udhëzime efektive përfshirë qasje në klasë dhe iniciativa në të gjithë shkollën që fokusohen në strategjitë për parandalimin e ngacmimit dhe zhvillimin e aftësive sociale. Kjo do të garantojë që të gjithë nxënësit në klasat 4-12 do të marrin udhëzime të përshtatshme për moshën e tyre.

B. Qasjet e përgjithshme të mësimi që ndihmojnë përpjekjet për parandalimin e ngacmimeve. Shkollat Publike të Worcester-it vënë theksin në qasjet e mëposhtme në të gjitha shkollat sepse ata janë një pjesë integrale e krijimit të një ambjenti shkollor të sigurtë dhe ndihmues. Këto nënvizojnë rëndësinë e iniciativave tona për parandalimin dhe ndërhyrjen ndaj ngacmimeve:

- vendosja e pritshmërive të qarta për nxënësit dhe krijimi i rutinave në shkollë dhe klasë;
- krijimi i një ambjenti shkollor të sigurtë për të gjithë nxënësit, përfshirë nxënësit me paaftësi, lezbiket, gay, biseksualët, transgender, dhe nxënësit e pastrehë;
- përdorimi i përgjigjeve të duhura pozitive dhe përforcime, edhe kur nxënësit i nevojitet disiplinim;
- përdorimi i mbështetjes për sjelljet pozitive;
- inkurajimi i të rriturve për të krijuar marrëdhënie pozitive me nxënësit;
- modele, mësim, dhe shpërblime për sjelljet por-sociale, të dobishme, dhe të respektueshme;
- përdorimi i qasjeve pozitive për sjelljet e shëndetshme, përfshirë zgjidhjen bashkëpunuese të problemeve, trajnim për zgjidhjen e konflikteve, punë në ekip, dhe mbështetje pozitive për sjellje që ndihmon në zhvillimin social dhe emocional;
- përdorimin e sigurtë të internetit përfshirë programin ISafe.
- mbështetja për interesat e nxënësit dhe pjesëmarrja në aktivitete jo-mësimore dhe jashtë-shkollore, veçanërisht në fushat e tyre të forcës.

V. RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR RAPORTIMIN DHE PERGJIGJEN NDAJ NGACMIMIT DHE HAKMARRJES

Për të garantuar një mjedis të sigurtë mësimi, Shkollat Publike të Worcester-it kanë të vendosura rregulla dhe procedura për marrjen dhe përgjigjen ndaj raporteve të ngacmimit ose hakmarrjes dhe për të garantuar se anëtarët e komitetit të shkollës- nxënësit, prindërit, dhe stafi i shkollës- e dinë se çfarë duhet të ndodhë kur ndodhin incidente ngacmimi (Shtojca). Plani përshkruan procedura të detajuara se si stafi e raporton incidentin, proceset për komunikimin me nxënësit dhe familjet, se si të bëhen raportimet (përfshirë raportimet anonime), dhe procedurat që duhet të ndiqen nga drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj kur drejtori ose asistenti janë agresorët e pretenduar, ose komiteti i shkollës kur superintendent është agresori i pretenduar, sapo të bëhet raportimi.

A. Raportimi i ngacmimit ose hakmarrjes. Raportimet për ngacmim ose hakmarrje mund të bëhen nga stafi, nxënësit, prindërit ose kujdestarët, ose kushdo tjetër, dhe mund të bëhet me gojë ose me shkrim. Të gjitha raportimet me gojë duhet që të regjistrohen me shkrim nëpërmjet një forme të Worcester Public Schools Administrators Bullying Prevention and Intervention Incident Reporting Form (Shtojca). Anëtarëve të stafit të shkollës dhe distriktit u kërkohet që të raportojnë -tek drejtori ose nën-drejtori, ose tek superintendent kur drejtori ose nën-drejtori janë ngacmuesit e pretenduar, ose tek komiteti i shkollës kur superintendent është agresori i pretenduar-, çdo instancë ngacmimi ose hakmarrjeje për të cilën vihet në dijeni, ose është dëshmitar anëtar i stafit përpara përfundimit të ditës. Raportimet e bëra nga nxënësit, prindërit ose kujdestarët, ose individë të tjerë të cilët nuk janë anëtarë të stafit të shkollës ose distriktit, mund të bëhen në mënyrë anonime. Shkollat Publike të Worcester-it kanë krijuar një adresë postare (School Safety Office, 20 Irving Street Room 101), një numër faksi (508-799-3173) dhe një adresë email reportbullying@worc.k12.ma.us me qëllim të raportimit të ngacmimeve ose hakmarrjeve. Kushdo që është i/e interesuar që të raportojë akte ngacmimi, gjithashtu mund të telefonojë “Anonymous Bullying Reporting Line” në 508-799-3472.

Përdorimi i një Forme për Raportimin e Incidentit nuk është e kërkuar dhe nuk është një kusht për bërjen e një raportimi. Megjithatë, çdo drejtori shkolle ose të emëruari administrativ i kërkohet që të plotësojë një Incident Report Form and Administrative Bullying Prevention për çdo raportim ngacmimi nga nxënësit, stafi, prindërit, ose burimet e tjera. Gjithashtu çdo shkollë do të: 1) vendosë një kopje të Incident Reporting Form në paketë për nxënësit dhe prindrit/kujdestarët. 2) do ta ketë atë të disponueshme në zyrën qendrore të shkollës, në zyrën e konsultimit, në zyrën e Infermieres së shkollës, dhe në vende të tjera që do të përcaktohen nga drejtori ose i emëruari administrativ. 3) do ta publikojnë atë në faqen e internetit të distriktit

(preventbullying.worcesterschools.org) dhe në faqen e internetit të çdo shkolle. The Administrative Bullying Prevention and Incident Reporting Form do të jetë e disponueshme në gjuhët më prevalente të origjinës së nxënësit dhe prindit ose kujdestarit.

Në fillim të çdo viti shkollor, Shkollat Publike të Worcester-it do ti ofrojnë komunitetit të shkollës, përfshirë por jo limituar në, mësuesit, administrata, infermjera e shkollës, punëtorët e menciës, mirëmbajtësit, shoferët e autobuzëve, trajnerët, këshilltarët për aktivitetet extra mësimore, para-profesionalët, nxënësit, prindërit ose kujdestarët, me një njoftim me shkrim për rregullat për raportimin e akteve të ngacmimit dhe hakmarrjes. Një përshkrim të procedurave të raportimit dhe risurset, përfshirë emrin dhe informacionin e kontaktit të drejtorit ose të emëruarit administrativ, si dhe të superintendentit dhe të emëruarit të saj kur drejtori është agresori i pretenduar, ose të komitetit të shkollës kur superintendent është agresori i pretenduar, do të përfshihen në manualin e stafit dhe nxënësve, në adresën e internetit të Shkollave Publike të Worcester-it, (preventbullying.worcesterschools.org), dhe në informacionin rreth Planit që është bërë i disponueshëm për prindërit ose kujdestarët.

1. Raportimi nga Stafit

Cdo anëtar i stafit do të raportojë tek drejtorit ose tek i/e emëruari administrativ, ose tek superintendent ose i emëruari i saj kur drejtori është agresori i pretenduar, ose tek komiteti i shkollës kur superintendent është agresori i pretenduar, kur ai/ajo janë dëshmitarë ose njoftohen për sjellje që mund të jetë ngacmim ose hakmarrje. Kërkesa për raportim tek drejtorit ose tek i/e emëruari administrativ, ose tek superintendent ose i emëruari i saj kur drejtori është agresori i pretenduar, ose tek komiteti i shkollës kur superintendent është agresori i pretenduar, nuk limiton autoritetin e anëtarit të stafit për t'ju përgjigjur çdo sjelljeje ose incidenti disiplinor në përputhje me rregullat dhe procedurat e shkollës ose distriktit shkollor për manaxhimin e sjelljes dhe disiplinës. Ky proces mund të fillohet duke plotësuar Teacher Referral ose Office Discipline Referral Form ose Bullying Incident Report Form (Shtojca).

2. Raportimi nga Nxënësit, Prindërit ose Kujdestarët, dhe të Tjerët

Shkolla ose distrikti pret nga nxënësit, prindërit ose kujdestarët, ose kushdo tjetër që ka qënë dëshmitar ose është vënë në dijeni për një rast ngacmimi ose hakmarrjeje që përfshin një nxënës ose anëtar stafi ta raportojnë atë tek drejtorit ose tek i/e emëruari administrativ, ose tek superintendent ose i emëruari i saj kur drejtori është agresori i pretenduar, ose tek komiteti i shkollës kur superintendent është agresori i pretenduar. Raportimet mund të jenë anonime, por nuk mund të merret një masë disiplinore karshi një agresori të pretenduar vetëm në bazë të një raportimi anonim. Nxënësit, prindërit ose kujdestarët, ose kushdo tjetër mund të kërkojnë ndihmë nga një anëtar i stafit për të plotësuar një raport me shkrim. Nxënësve do tu ofrohen mënyra praktike, të sigurta, private, dhe të përshtatshme për moshën e tyre, të raportimit dhe diskutimit të një incidenti ngacmimi me anëtarët e stafit, ose me drejtorin ose të emëruarin administrativ, ose superintendent ose të emëruarin e saj kur drejtori ose asistenti është agresori i pretenduar.

B. Përgjigjia ndaj raportimit për ngacmim ose hakmarrje- Akuza për Ngacmim nga një Nxënës

1. Siguria

Përpara se të investigojë plotësisht akuzat për ngacmim ose hakmarrje, drejtori ose i emëruari administrativ do të marrin disa hapa për të përcaktuar nevojën për rindosjen e sensit të sigurisë tek një objektivi(target) i pretenduar dhe/ose mbrojnë objektivin e pretenduar nga mundësia e më shumë incidenteve. Përgjigjet për të promovuar siguri mund të përfshijnë, por jo të limitohen tek, krijimi i një plani personal sigurie, para-përcaktim të uljes për objektivin dhe/ose agresorin në klasë, gjatë drekës, ose në autobus; caktimin e një anëtarit të stafit që do të jetë "personi i sigurisë" për objektivin; dhe alternimin e orarit dhe aksesin e agresorit ndaj objektivit. Drejtori ose i emëruari administrativ do të marrin hapa shtesë për promovimin e sigurisë gjatë dhe pas kohës së investigimit, sipas nevojës.

Drejtori ose i emëruari administrativ do të implementojnë strategji të përshtatshme për mbrojtjen nga ngacmimi ose hakmarrja të një nxënësi që ka raportuar ngacmimin ose hakmarrjen, të një nxënësi që ka qënë dëshmitar i një ngacmimi ose hakmarrje, të një nxënësi që ofron informacion gjatë një investigimi, ose të një nxënësi që ka informacion të sigurtë/saktë rreth një akti të raportuar ngacmimi ose hakmarrje.

2. Obligimi për të Njoftuar të Tjerët

- a. Njoftim për prindërit ose kujdestarët. Sapo të përcaktohet se ka pasur ngacmim ose hakmarrje, drejtori ose i emëruari administrativ do të njoftojnë menjëherë prindërit ose kujdestarët e objektivit/viktimës (target) dhe të agresorit për këtë gjë, dhe për procedurat për t'ju përgjigjur atij. Mund të ketë raste në të cilat drejtori ose i emëruari administrativ kontakton prindërit përpara çdo investigimi. Njoftimi do të jetë në përputhje me rregullat e shtetit në 603 CMR 49.00.
- b. Njoftim për një Shkollë ose Distrikt tjetër. Nëse incidenti i raportuar përfshin nxënës nga më shumë se një distrikt shkollor, shkollë charter, shkollë jo-publike, shkollë e aprovuar private për edukimin special, shkollë residenciale, ose shkollë bashkëpunuese, drejtori ose i emëruari administrativ në fillim duhet që të njoftojë me telefon drejtorin ose të emëruarin e shkollës(ve) tjetër për incidentin në mënyrë që çdo shkollë të marrë masat e duhura. Cdo komunikim do të bëhet në përputhje me ligjet dhe rregullat e shtetit dhe federale për privatësinë, dhe me 603 CMR 49.00.
- c. Njoftim për Organet e Zbatimit të Ligjit. Në çdo moment pas marrjes së raportimit për ngacmim ose hakmarrje, përfshirë pas një investigimi, nëse drejtori ose i emëruari administrativ ka një bazë të arsyeshme për të besuar se duhet të ngrihen akuza kriminale kundër agresorit, drejtori ose i emëruari administrativ do të njoftojnë agjensitë lokale të zbatimit të ligjit. Gjthashtu, nëse ndodh ndonjë incident në ambjentet e shkollës që përfshin një ish nxënës nën moshën 21 vjeçare, që nuk është më i regjistruar në shkollë, drejtori ose i emëruari administrativ duhet që të kontaktojë agjensitë e zbatimit të ligjit, nëse ai ose ajo ka një bazë të arsyeshme besimi se akuza kriminale duhet të ngrihen kundër nxënësit agresor.

Në marrjen e këtij vendimi, drejtori ose i emëruari administrativ do të konsultohen me School Safety Liaison dhe me individë të tjerë që drejtori ose i emëruari administrativ e shikon të arsyeshme, në përputhje me Planin dhe me rregullat dhe procedurat e aplikueshme të shkollës ose distriktit.

- C. Investigimi. Drejtori ose emëruari administrativ do të investigojnë të gjitha raportimet për ngacmim ose hakmarrje brenda 24 orësh, ose ditën tjetër të shkollës, pas marrjes së raportimit dhe, duke bërë këtë, do të konsiderojnë të gjithë informacionin e njohur, përfshirë natyrën e akuzave dhe moshën e nxënësve të përfshirë.

Gjatë investigimit drejtori ose i emëruari administrativ, ndërmjet gjërave të tjera, do të marrin në pyetje nxënësin, stafin, prindërit ose kujdestarët, dhe çdo person tjetër që ka lidhje. Drejtori ose i emëruari administrativ do të rikujtojnë nxënësit agresor, objektivit, dhe dëshmitarëve rëndësishëm të investigimit, detyrimin e tyre për të vërtetën dhe, se hakmarrja është e ndaluar reptësisht dhe se ajo do të çojë në veprime disiplinore.

Drejtori ose i emëruari administrativ, ose anëtarë të tjerë të stafit siç mund të përcaktohet nga drejtori ose i emëruari administrativ, dhe në konsultim me konsullorin e shkollës, do të zhvillojnë intervistat sipas nevojës. Për aq sa është praktike dhe duke parë detyrimin e tij/saj për të adresuar çështjen, drejtori ose i emëruari administrativ do të mbajnë konfidencialitetin gjatë procesit të investigimit. Drejtori ose i emëruari administrativ do të mbajnë një rekord me shkrim të investigimit (Administrator's Bullying Prevention and Intervention Incident Report Form – Shtojca).

Nëse është e domosdoshme, drejtori ose i emëruari administrativ do të konsultohen me konsullorë legalë rreth investigimit. Procedurat për investigimin e raportimeve të ngacmimit dhe hakmarrjes do të jenë në përputhje me procedurat dhe rregullat për investigimin të Shkollave Publike të Worcester-it.

- D. Përcaktimet/Vendimet. Drejtori ose i emëruari administrativ do të marrin vendimet bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat. Nëse, pas investigimit, ngacmimi ose hakmarrja është vërtetuar, drejtori ose i emëruari administrativ do të marrin hapa të llogaritur në mënyrë të arsyeshme për të parandaluar përsëritjen dhe për të siguruar se objektivi/target nuk është i/e kufizuar për të marrë pjesë në shkollë ose në përfitim nga aktivitetet e shkollës. Drejtori ose i emëruari administrativ do të: 1) përcaktojë se çfarë veprimi përmirësues kërkohet, nëse ka, dhe 2) të përcaktojë se çfarë veprim i përgjegjshëm dhe/ose veprim disiplinor janë të nevojshëm.

Në varësi të rrethanave, drejtori ose i emëruari administrativ mund të zgjedhin që të konsultohen me mësuesin(ët) e nxënësit dhe/ose konsullorin e shkollës, dhe me prindërit ose kujdestarët e objektivit dhe agresorit, për të identifikuar çdo problem social ose emocional që mund të ketë ndihmuar në sjelljen ngacmuese dhe për të përcaktuar nivelin e ndihmës shtesë që duhet dhënë për zhvillimin e sjelljeve sociale

Drejtori ose i emëruari nga administrata do të njoftojnë prindërit ose kujdestarët e viktimës dhe agresorit rreth rezultateve të investigimit brenda 24 orësh ose ditën e ardhshme të shkollës nga përfundimi i investigimit dhe, nëse gjendet se ka ngacmim ose hakmarrje, se çfarë hapash do të merren për parandaluar akte të mëtejshëm ngacmimi ose hakmarrjeje. Të gjitha njoftimet për prindërit duhet që të jenë në përputhje me ligjet dhe rregullat e aplikueshme për privatësinë të shtetit dhe ato federale. Për shkak të kërkesave ligjore në lidhje me konfidencialitetin e rekordeve të nxënësit, drejtori ose i emëruari administrativ nuk mund të raportojnë informacion specifik tek prindërit ose kujdestarët e viktimës në lidhje me masat e mara disiplinore përveç se rastit kur ai përmban një urdhër "qëndro larg" ose direktiva të tjera që viktima duhet ti dijë në mënyrë që të raportojë shkeljet.

- Përgjigjia ndaj Ngacmimit.

Qasja proaktive e Shkollave Publike të Worcester-it në lidhje me parandalimin dhe ndërhyrjen ndaj ngacmimeve garanton një mjedis mësimor të sigurtë për të gjithë nxënësit përfshirë ndryshimin e sjelljeve të agresorëve.

1. Marrja e Masave Disiplinore

Nëse drejtori ose i emëruari administrativ vendosin se masat disiplinore janë të përshtatshme, masat disiplinore do të përcaktohen në bazë të fakteve të gjetura nga drejtori ose i emëruari administrativ, përfshirë natyrën e sjelljes, moshën e nxënësit(ve) të përfshirë, si dhe nevojën për të balancuar përgjegjësinë me të mësuarën e sjelljeve të përshtatshme. Disiplina do të jetë në përputhje me Planin dhe me Kodin e Sjelljes të Shkollave Publike të Worcester-it. Ne do të ndjekim udhëzimet për procedurat disiplinore për nxënësit me paaftësi siç përshkruhet në Individuals with Disabilities Education Improvement Act (IDEA). Në përgjigje të ngacmimit, Shkollat Publike të Worcester-it do të marrin në konsideratë një sërë pasojash që mund të përfshijnë humbjen e privilegjeve, detention, pezullim, Safety Center Referral, referim tek agjensitë jashtë shkolle, shërbime komuniteti, ose krijimin e një Aggressor Intervention Plan që mund të përmbajë komponentë edukativë.

2. Mësimi i Sjelljeve të Përshtatshme nëpërmjet Ndërtimit të Aftësive (Skills-Building)

Komponentët edukativë të një Aggressor Intervention Plan mund të përfshijnë udhëzime për sjelljen e përshtatshme nëpërmjet ndërtimit të aftësive (p.sh. Positive Behavior Intervention dhe Supports Program, Second Step, Steps to Respect dhe Health Education) dhe/ose Aggressor Intervention Meeting. Qasje të tjera për ndërtimin e aftësive që drejtori ose i emëruari administrativ mund të konsiderojnë përfshijnë:

- ofrimi i sesioneve individuale për ndërtimin e aftësive bazuar në programin e parandalimit të ngacmimit të shkollës/distriktit;
- ofrimi i aktiviteteve mësimore relevante për nxënës individualë ose grupe nxënësish, në konsultim me konsullorët dhe konsullorët udhëzues si dhe personel tjetër të përshtatshëm shkolle;
- implementimi i një game ndihmash akademike ose jo-akademike për sjelljet pozitive, për të ndihmuar nxënësit që të kuptojnë rrugë pro-sociale për të arritur qëllimet e tyre;
- takimi me prindërit ose kujdestarët për të marrë mbështetjen prindërore dhe për të përforcuar programin e anti-ngacmimit dhe aftësitë e ndërtimit të aftësive sociale në aktivitetet në shtëpi;
- adoptimi i planeve të sjelljes përfshirë një fokusim në krijimin e aftësive sociale specifike; dhe
- bërja e një reference për vlerësim

Nëse drejtori ose i emëruari administrativ përcakton se një nxënës me vetëdije bëri një akuzë fallco për ngacmim ose hakmarrje, ai/ajo nxënës mund të jetë subjekt për masa disiplinore.

3. Promovimi i Sigurisë për Viktimën dhe të Tjerët

Drejtori ose i emëruari administrativ do të konsiderojnë se çfarë ndreqjesh, nëse ka nevojë, janë të nevojshme në mjedisin shkolle për

të rritur sensin e sigurisë të viktimës dhe të tjerëve. Një strategji që drejtori ose i emëruari administrativ mund të përdorin është shtimi i mbikqyrjes nga të rriturit në kohët e tranzicionit dhe në vendet e ditura që ka ndodhur ngacmimi ose që ka mundësi që të ndoshë. Së dyti, do të implementohet një Student Target Intervention Plan (Shojca) për çdo nxënës që është konfirmuar që ka qënë viktimë. Të gjithë prindërit do të përfshihen dhe do të marrin një kopje të Student Target Intervention Plan të vajzës ose djalit të tyre.

Pas përcaktimit dhe urdhërit për dëmshpërblim ose masa disiplinore, drejtori ose i emëruari administrativ do të mbajnë një kontakt të vazhdueshëm me viktimën për të përcaktuar nëse ka pasur përsëritje të sjelljes së ndaluar dhe nëse janë të nevojshme masa ndihmuese të tjera. Nëse po, drejtori ose i emëruari administrativ do të bashkëpunojë me anëtarët e duhur të stafit për ti implementuar ato menjëherë.

F. Përgjigjia ndaj një raportimi për ngacmim ose hakmarrje- Akuzat për Ngacmim nga Stafi i Shkollës

Shkollat Publike të Worcester-it kanë krijuar rregulla dhe procedura për të adresuar se si do të përgjigjet shkolla dhe se si do të ofrojë planifikim të sigurisë, njoftim për prindin kujdestarin dhe të tjerët, investigim dhe përgjigje. Rregullat dhe procedurat aktuale adresojnë sjelljen a papranueshme nga stafi i shkollës. Drejtori ose i emëruari i tij, ose superintendent ose i emëruari i saj kur drejtori ose asistenti është agresori i pretenduar, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre kur superintendent është agresori i pretenduar, do të rikujtojnë antarit të pretenduar agresor të stafit rëndësinë e investigimit, obligimet e tyre për të vërtetën dhe se hakmarrje ndaj kujtdo që raporton ngacmimin ose ofron informacion gjatë një investigimi është rreptësisht e ndaluar dhe mund të shpjerë në masa disiplinore.

1. Siguria

Përpara se të investigojë plotësisht akuzat për ngacmim ose hakmarrje, drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj kur drejtori është agresori i pretenduar, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre kur suprintendet është agresori i pretenduar do të marrin disa hapa për të përcaktuar nevojën për rivedosjen e sensit të sigurisë tek një viktimë(target) i pretenduar dhe/ose mbrojnë viktimën e pretenduar nga mundësia e më shumë incidenteve. Përgjigjet për të promovuar siguri mund të përfshijnë, por jo të limitohen tek, krijimi i një plani personal sigurie. Drejtori ose i emëruari administrativ do të marrin hapa shtesë për promovimin e sigurisë gjatë dhe pas kohës së investigimit, sipas nevojës.

Drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, do të implementojnë strategji të përshtatshme për mbrojtjen nga ngacmimi ose hakmarrja të një nxënësi që ka raportuar ngacmimin ose hakmarrjen, të një nxënësi që ka qënë dëshmitar i një ngacmimi ose hakmarrje, të një nxënësi që ofron informacion gjatë një investigimi, ose të një nxënësi që ka informacion të sigurtë/saktë rreth një akti të raportuar ngacmimi ose hakmarrjeje.

2. Obligimi për të njoftuar të Tjerët

- a. Njoftim për prindërit ose kujdestarët. Sapo të përcaktohet se ka pasur ngacmim ose hakmarrje, drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj kur drejtori është agresori i pretenduar, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre kur suprintendet është agresori i pretenduar do të njoftojnë menjëherë prindërit ose kujdestarët e viktimës dhe të agresorit për këtë gjë, si dhe për procedurat për t'ju përgjigjur atij. Mund të ketë raste në të cilat drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, kontakton prindërit përpara çdo investigimi. Njoftimi do të jetë në përputhje me rregullat e shtetit në 603 CMR 49.00.
- b. Njoftim për një Shkollë ose Distrikt tjetër. Nëse incidenti i raportuar përfshin nxënës nga më shumë se një distrikt shkollor, shkollë charter, shkollë jo-publike, shkollë e aprovuar private për edukimin special, shkollë residenciale, ose shkollë bashkëpunuese, drejtori ose i emëruari administrativ ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, në fillim duhet që të njoftojë me telefon drejtorin ose të emëruarin e shkollës(ve) tjetër për incidentin në mënyrë që çdo shkollë të marrë masat e duhura. Cdo komunikim do të bëhet në përputhje me ligjet dhe rregullat e shtetit dhe federale për privatësinë dhe me 603 CMR 49.00.
- c. Njoftim për Organet e Zbatimit të Ligjit. Në çdo moment pas marrjes së raportimit për ngacmim ose hakmarrje,

përfshirë pas një investigimi, nëse drejtori ose i emëruari administrativ ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, ka një bazë të arsyeshme për të besuar se duhet të ngrihen akuza kriminale kundër agresorit, drejtori ose i emëruari administrativ ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, do të njoftojnë agjensitë lokale të zbatimit të ligjit. Njoftimet do të jenë në përputhje me kërkesat e 603 CMR 49.00 si dhe marrëveshjet lokale të krijuara me agjensitë lokale të zbatimit të ligjit.

Gjthashtu, nëse ndodh ndonjë incident në ambjentet e shkollës që përfshin një ish nxënës nën moshën 21 vjeçare që nuk është më i regjistruar në shkollë, drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, duhet që të kontaktojnë agjensitë e zbatimit të ligjit nëse ai ose ajo ka një bazë të arsyeshme besimi se akuza kriminale duhet të ngrihen kundër nxënësit agresor. Në marrjen e këtij vendimi, drejtori ose i emëruari administrativ ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, në përputhje me Planin dhe me rregullat dhe procedurat e aplikueshme të shkollës ose distriktit do të konsultohen me School Safety Liaison dhe me individë të tjerë që drejtori ose i emëruari administrativ ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre e shikon të arsyeshme.

C. Investigimi. Drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, do të investigojnë të gjitha raportimet për ngacmim ose hakmarrje brenda 24 orësh, ose ditën tjetër të shkollës, pas marrjes së raportimit, dhe, duke bërë këtë, do të konsiderojnë të gjithë informacionin e njohur, përfshirë natyrën e akuzave dhe moshën e nxënësve të përfshirë

Gjatë investigimit drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, ndërmjet gjërave të tjera, do të marrin në pyetje nxënësin, stafin, prindërit ose kujdestarët, dhe çdo person tjetër sipas nevojës. Drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, do të rikujtojnë anëtarit agresor të stafit, viktimës, dhe dëshmitarëve rëndësinë e investigimit, detyrimin e tyre për të vërtetën, se hakmarrja është e ndaluar rreptësisht dhe se ajo do të çojë në masa disiplinore.

Drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, ose anëtarë të tjerë të stafit siç mund të përcaktohet nga drejtori ose i emëruari administrativ, dhe në konsultim me manaxherin e burimeve njerëzore, do të zhvillojnë intervistat sipas nevojës. Për aq sa është praktike dhe duke parë detyrimin e tij/saj për të adresuar çështjen, drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, do të mbajnë konfidencialitetin gjatë procesit të investigimit dhe do të mbajnë një rekord me shkrim për investigimin (Administrator's Bullying Prevention and Intervention Incident Report Form – Shtojca).

Nëse është e domosdoshme, drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, do të konsultohen me konsullorë legalë rreth investigimit. Procedurat për investigimin e raportimeve të ngacmimit dhe hakmarrjes do të jenë në përputhje me procedurat dhe rregullat për investigimin të Shkollave Publike të Worcester-it.

D. Përcaktimet/Vendimet. Drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, do të marrin vendimet bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat. Nëse, pas investigimit, ngacmimi ose hakmarrja është vërtetuar, drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, do të marrin hapa të llogaritur në mënyrë të arsyeshme për të parandaluar përsëritjen dhe për të siguruar se viktimat nuk është i/e kufizuar për të marrë pjesë në shkollë ose në përfitimin nga aktivitetet e shkollës. Drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, do të: 1) përcaktojnë se çfarë veprimi dëmshpërblyes kërkohet, nëse ka, dhe 2) të përcaktojnë se çfarë veprimi i përgjegjshëm dhe/ose veprimi disiplinor janë të nevojshëm.

Drejtori ose i emëruari nga administrata, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, do të njoftojnë prindërit ose kujdestarët e viktimës dhe agresorin rreth rezultateve të investigimit brenda 24 orësh nga përfundimi i investigimit dhe, nëse gjendet se ka ngacmim ose hakmarrje, se çfarë hapash do të merren për parandaluar akte të mëtejshëm ngacmimi ose hakmarrjeje. Të gjitha njoftimet për prindërit duhet që të jenë në përputhje me ligjet dhe rregullat e aplikueshme për privatësinë të shtetit dhe ato federale. Për shkak të kërkesave ligjore në lidhje me konfidencialitetin e rekordeve të nxënësit, drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre nuk mund të raportojnë informacion specifik tek prindërit ose kujdestarët e viktimës në lidhje me masat e mara disiplinore përveç se rastit

kur ai përmban një urdhër "qëndro larg" ose direktiva të tjera që viktimën duhet ti dijë në mënyrë që të raportojë shkeljet.

- Përgjigjia ndaj Ngacimit

Qasja proaktive e Shkollave Publike të Worcester-it në lidhje me parandalimin dhe ndërhyrjen ndaj ngacimeve garanton një mjedis mësues të sigurt për të gjithë nxënësit përfshirë ndryshimin e sjelljeve të agresorëve.

1. Marrja e Masave Disiplinore

Nëse drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, do të dërgojnë Bullying Incident Report Form dhe Administrator Bullying Incident Report Form, që konfirmojnë ngacimin tek manaxheri i burimeve njerëzore, i cili/cila do të bëjë një rekomandim tek superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, në lidhje me, se çfarë masash disiplinore duhet që të konsiderohen, nëse ka nevojë. Manaxheri i burimeve njerëzore mund të kryejë investigime të mëtejshme, nëse është e nevojshme. Superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, do të konsiderojnë natyrën e shkeljes, historinë e punësimit të punonjësit si dhe informacion tjetër të rëndësishëm që mund të bëhet i disponueshëm.

2. Mësimi i sjelljeve të përshtatshme nëpërmjet ndërtimit të aftësive

Cdo anëtar i stafit, që është vërtetuar se është angazhuar në sjellje të ndaluar sipas kësaj rregulloreje, do ti kërkohet që të kontaktojë Worcester Public School's Employee Assistance Program (Deer Oakes 866 327 2400) përpara se të kthehet në punë, nëse është e përshtatshme. Anëtarit të stafit do ti kërkohet gjithashtu që të marrë pjesë në zhvillimim e përshtatshëm të stafit siç caktohet nga superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre.

3. Promovimi i Sigurisë për Viktimën dhe të Tjerët

Do të implementohet një Student Target Intervention Plan (Shrojca) për çdo nxënësi që është konfirmuar se ka qënë viktimë/objektivi. Të gjithë prindërit do të përfshihen dhe do të marrin një kopje të Student Target Intervention Plan të djalit ose vajzës së tyre. Drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, do të konsiderojnë se çfarë ndreqjesh janë të nevojshme për tu bërë në mjedisin e shkollës për të rritur sensin e sigurisë së viktimës dhe të të tjerëve. Një strategji që drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, mund të përdorin është rivendosja e anëtarit të stafit ose nxënësit në ndërtesë ose në Distrikt tjetër. Pas përcaktimit dhe urdhërit për dëmshpërblim ose masa disiplinore, drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, do të mbajnë një kontakt të vazhdueshëm me viktimën për të përcaktuar nëse ka pasur përsëritje të sjelljes së ndaluar dhe nëse janë të nevojshme masa të tjera ndihmuese. Nëse po, drejtori ose i emëruari administrativ, ose superintendent ose i emëruari i saj, ose komiteti i shkollës ose i emëruari i tyre, do të bashkëpunojë me anëtarët e duhur të stafit për ti implementuar ato menjëherë, deri në dhe përfshirjen e disiplinës progresive të anëtarit të stafit.

VI. BASHKËPUNIMI ME FAMILJET

Resurset për familjet dhe për komunikimin e hapur me to janë një aspekt esencial i bashkëpunimit. Shkollat Publike të Worcester-it do të bashkëpunojnë nga afër me familjet për të shtuar më shumë kapacitetin e shkollës dhe distriktit për parandalimin dhe përgjigjen ndaj ngacimit. Informacioni i ndarë me familjet fokusohet në: (i) se si prindërit dhe kujdestarët mund të përforcojnë programin në shtëpi dhe, të mbështesin planin e shkollës dhe distriktit; (ii) dinamikën e ngacimit; dhe (iii) siguria në internet dhe ngacimi kibernetik.

Prindërit dhe kujdestarët gjithashtu do të njoftohen me shkrim çdo vit rreth seksioneve që lidhen me nxënësit të Bullying Prevention and Intervention Plan, në gjuhët më të përhapura ndërmjet prindërve dhe kujdestarëve. Qasjet specifike ndaj bashkëpunimit të shkollës ose distriktit marrin parasysh moshën, klimën, faktorët social-ekonomikë, gjuhën, dhe përbërjen kulturore të nxënësve dhe

prindërve.

- A. Edukimi i prindërve dhe risurset. Shkollat Publike të Worcester-it ofrojnë programe edukativë për prindërit dhe kujdestarët, që fokusohen në komponentët prindërorë të programit të anti-ngacmimit dhe, programin për kompetencën sociale që përdoret nga distrikti. Programet ofrohen në bashkëpunim me Parent Information Center, City-wide Parent Advisory Council, School Councils, Special Education Parent Advisory, dhe organizata të tjera të ngjashme.
- B. Kërkesat e njoftimit. Cdo vit distrikti informon prindërit ose kujdestarët e nxënësve të regjistruar rreth programit anti-ngacmim që po përdoret. Letrat për prindërit dërgohen në shtëpi nga drejtori dhe mësuesit e shëndetsisë, të cilat ofrojnë informacion rreth programit për parandalimin dhe ndërhyrjen ndaj ngacmimit që po mësojnë fëmijët e tyre. Gjithashtu, ofrohen mundësi për të parë materialet, për të folur me mësuesit dhe për të marrë pjesë në mbledhje informale të hapur për të gjithë prindërit/kujdestarët rreth dinamikës së ngacmimit, përfshirë ngacmimin kibernetik dhe sigurinë në internet. Distrikti do të dërgojë prindërve çdo vit letër rreth seksioneve të Planit që kanë lidhje me nxënësit si dhe Internet Safety Policy të distriktit. Të gjitha njoftimet dhe informacionet që u jepen prindërve dhe kujdestarëve janë në letër dhe format elektronik, dhe janë të disponueshme në gjuhët më të përhapura ndërmjet prindërve dhe kujdestarëve. Distrikti e ka vendosur Planin dhe informacionin e lidhur me të në adresën e tij të internetit.

VII. NDALIMI KUNDER NDACMIMIT DHE HAKMARRJES

Shkollat Publike të Worcester-it kanë të përfshirë në këtë plan, në kodin e sjelljes së nxënësit, manualin e nxënësit, dhe buletin e Superintendent një deklaratë që ndalon ngacmimin, ngacmimin kibernetik dhe hakmarrjen. Deklarata e mëposhtme është marrë direkt nga M.G.L. c. 71, § 370 (b), dhe përshkruan kërkesat e ligjt për parandalimin e ngacmimit.

Aktet e ngacmimit (bullying), që përfshijnë ngacmimin kibernetik, janë të ndaluara:

- (i) në ambjentet e shkollës dhe pronën e ngjitur me ambjentin e shkollës, në një aktivitet të sponsorizuar nga shkolla ose që është i lidhur me shkollën, ceremoni, ose program, si në ambjentin e shkollës ashtu edhe jashtë tij, në një ndalesë autobuzi të shkollës ose automjeti tjetër në pronësi, të marrë me qira, ose që përdoret nga distrikti ose shkolla; ose nëpërmjet përdorimit të teknologjisë ose pajisjeve elektronike në pronësi, me qira, ose që përdoren nga distrikti shkollor ose shkolla; dhe
- (ii) në një vend, aktivitet, ceremoni, ose program që nuk është i lidhur me shkollën nëpërmjet përdorimit të teknologjisë ose një pajisjeje elektronike që nuk është pronë, me qira, ose nuk përdoret nga një distrikt shkollor ose shkollë, nëse akti krijon një ambjent të tensionuar në shkollë për viktimën ose dëshimtarin, shkel të drejtat e tyre në shkollë, ose materialisht ose substancialisht prish procesin mësimor ose radhën e veprimeve në shkollë.

Hakmarrja ndaj një personi që raporton ngacmimin, ofron informacion gjatë investigimit, ose është dëshimtar ose ka informacion të besueshëm rreth ngacmimit, është gjithashtu e ndaluar.

VIII. PERKUFIZIMET

Disa nga përkufizimet e mëposhtme janë kopjuar direkt nga M.G.L. c. 71, § 370, siç vihet në dukje mëposhtë. Shkollat Publike të Worcester-it nuk e kanë alternuar kuptimin ose qëllimin e tyre.

Agresor është një nxënës ose anëtar i stafit që angazhohet në ngacmim, ngacmim kibernetik, ose hakmarrje.

Ngacmimi (Bullying), siç përkufizohet në M.G.L. c. 71, § 370, është përdorimi i përsëritur nga një ose më shumë nxënës, ose një anëtar i stafit, i shprehjeve me shkrim, gojë ose elektronike ose akt fizik ose gjest ose çdo kombinim i tyre, drejtuar një viktime që:

1. shkakton dëmtim fizik ose emocional ndaj viktimës ose dëmton pronën e viktimës;
2. vendos viktimën në një frikë të arsyeshme për dëmtim të tij ose saj ose për dëmtimin e pronës së tij ose saj;
3. krijon një ambjent të tensionuar në shkollë për viktimën;
4. cënon të drejtat e viktimës në shkollë; ose
5. materialisht ose substancialisht prish procesin mësimor ose radhën e veprimeve në shkollë. *Ngacmimi (bullying) duhet të përfshijë edhe ngacmimin kibernetik (cyberbullying).*

Ngacmimi kibernetik është ngacmimi nëpërmjet përdorimit të teknologjisë ose pajisjeve elektronike siç janë telefonat, telefonat celularë, kompjuterat, dhe Interneti. Gjithashtu përfshin, por nuk limitohet në, email, mesazhe e çastit, mesazhet me tekst, dhe postimet në Internet. Shiko M.G.L. c. 71, § 37O për përkufizimin legal të ngacmimit kibernetik.

Mjedisi i tensionuar/armiqësor, siç përcaktohet në M.G.L. c. 71, § 37O, është një situatë në të cilën ngacmimi shkakton në mjedisin shkollor përhapjen e frikës, thalljes, ose fyerjeve dhe që është i rëndë dhe përhapur sa duhet, për të ndryshuar kushtet e edukimit të nxënësit.

Hakmarrja është çdo formë e intimidimit, raprezaljes, ose ngacmimit e drejtuar kundër një nxënësi që raporton ngacmimin, ofron informacion gjatë një investigimi ngacmimi, ose është dëshmitar ose ka informacion të besueshëm rreth ngacmimit.

Stafi i Shkollës përfshin, por nuk limitohet në, mësuesit, administratorët, konsullorët, infermieren e shkollës, mirëmbajtësit, shoferët e autobusëve, punonjësit e mencave, trajnerët e sporteve, këshilltarët, këshilltarët për aktivitetet jashtë shkollore dhe paraprofesionale.

Target/viktima është një nxënës ndaj të cilit/cilës është kryer ngacmim, ngacmim kibernetik ose hakmarrje.

IX. LIDHJA ME LIGJET E TJERA

Në përputhje me ligjet e shtetit dhe ato federale, si dhe me rregulloret e Shkollave Publike të Worcester-it, asnjë person nuk duhet të diskriminohet për pranim në një shkollë publike të çdo qyteti, ose në marrjen e avantazheve, privilegjit dhe klasave të studimit në këto shkolla për shkak të racës, ngjyrës, seksit, besimit fetar, origjinës kombëtare, ose orientimit seksual. Asgjë në Plan nuk ndalon shkollën ose distriktin për marrjen e masave për të korigjuar diskriminimin ose ngacmimin bazuar në anëtarësimin e personit në një kategori të mbrojtur legale sipas ligjeve lokale, të shtetit dhe atyre federale, ose rregulloreve të shkollës ose distriktit.

(Shtojca – The Worcester Public Schools Policy and Procedures)

Veç kësaj, asgjë në Plan nuk është krijuar ose ka qëllim limitimin e autoritetit të shkollës ose distriktit për të marrë masa disiplinore ose veprime të tjera sipas M.G.L. c. 71, §§ 37H or 37H½, M.G.L. c71 §§41 and 42, M.G.L. c76 §, ligjeve të tjera të përshtatshme, ose rregullave të shkollës ose distriktit, ose marrëveshjeve të volitshme kolektive, në përgjigje të sjelljes së dëmshme, violente ose shqetësuese, pavarësisht se Plani mbulon sjelljen.

X. SHTOJCE

- Departamenti i Studimit të fëmijës (Child Study Department)
- Procesi Pranimi i Bazuar në Shkollë (School-Based Intake Process)
- Rregullat dhe Proçedurat e Shkollave Publike të Worcester-it për Ngacmimin
- Forma e Raportimit të Incidentit të Shkollave Publike të Worcester-it
- Forma e Raportimit të Incidentit Parandalimit dhe Ndërhyrjes së Shkollave Publike të Worcester-it
- Forma e Administratorit për Raportimin e Incidentit dhe Parandalimin e Ngacmimit të Shkollave Publike (Public Schools Administrator's Bullying Prevention and Intervention Incident Report Form)
- Forma e Referimit të Mësuesit të Shkollave Publike të Worcester-it
- Kodi i Shkeljes Disiplinore
- Plani i Ndërhyrjes për Sulmin ndaj Nxënësit të Shkollave Publike të Worcester-it
- Plani i Ndërhyrjes për Sulmin ndaj Stafit të Shkollave Publike të Worcester-it
- Plani i Ndërhyrjes për Nxënësin Objektiv të Shkollave Publike të Worcester-it



FORME RAPORTUESE E INCIDENTIT DHE E PARANDALIMIT DHE NDERHYRJES SE NGACMIMIT (BULLYING)

1. Emri i Raportuesit/Personit që Plotëson Raportin: _____
(Shënim: Raportet mund të bëhen në mënyrë anonime, por nuk mund të merret asnjë masë disiplinore kundër një agresori të supozuar, vetëm në bazë të një raporti anonim.)

2. Shënoni nëse ju jeni: Objektivi i Sjelljes Raportues (Jo Objektivi)

3. Shënoni nëse ju jeni një: Nxënës Anëtar i Stafit (rol i specifik) _____
 Prind Administrator Tjetër (Specifikojë) _____

Informacioni i kontaktit tuaj/numri i telefonit: _____

4. Nëse je nxënës, deklaroni shkollën tuaj: _____ Klasa: _____

5. Nëse je anëtar i stafit, deklaroni shkollën tuaj ose vendin e punës: _____

6. Informacion rreth Incidentit:

Emri i Objektivit (të sjelljes) (Viktima): _____

Emri i Agresorit (Personi që u angazhua në sjellje) (Ngacmuesit (Bully)): _____

Data(t) e Incidentit(ve): _____

Ora kur Ndodhi Incidenti(et): _____

Vendndodhja a Incidentit(ve) (Tregohu sa më specifik të jetë e mundur): _____

7. Dëshmitarët (Rendisni të gjithë personat që e panë incidentin ose që kanë informacion rreth tij):

Emri: _____ Nxënës Staf Tjetër _____

Emri: _____ Nxënës Staf Tjetër _____

Emri: _____ Nxënës Staf Tjetër _____

8. Përshkruani detajet e incidentit (përfshirë emrat e njerëzve të përfshirë, çfarë ndodhi, dhe çfarë bëri dhe tha çdo person, përfshirë fjalë specifike që u përdorën). Ju lutem nëse është e nevojshme përdorni pjesën e pasme të formës.

VETEM PER PERDORIM ADMINISTRATIV

9. Firma e Personit që Dorëzon Këtë Raport: _____ Data: _____
(Shënim: Raportet mund të bëhen edhe anonimë.)

10. Forma ju dha: _____ Pozicioni: _____ Date: _____

Format e plotësuar mund të dorëzohen tek zyra e shkollës suaj ose mund të postohen ose faksohen në School Safety Office si në vijim:

Posto tek: School Safety Office, Worcester Public Schools, 20 Irving Street, Room 101, Worcester, MA 01609 or fakso tek : 508-799-3173

Telefononi ose dërgoni Email tek Safety Office me çdo pyetje që mund të keni rreth procedurave të raportimit të ngacmimit (bullying) në: reportbullying@worc.k12.ma.us or 508-799-3472